


Për vjeljen e këtyre thënieve
dhe inkurajimin
që ato të botohen e falënderoj
Besën dhe Asllanin nga Nju-Xhersi.
Allahu i shpërbleftë!



Mulla Beqa rrëfente ...


“Muaji i Ramazanit ishte një muaj të cilin mbarë Shqipëria e priste me respekt. Por, diçka më e thellë dhe më me peshë se kjo ishte se tri ditët e fundit para Bajramit për dyqanxhinjtë dhe besimtarët e pasur ishte periudha e regjistrimit të mallit, që në fakt ka qenë përgatitje për dhënien e zekatit dhe sadakatul fitrit. Andaj gjatë këtyre ditëve rrugët e qyteteve ndriçoheshin me llamba vajguri”. Me një fjalë, një përshtkrim i Shqipërisë dhe shqiptarëve si “Jerusalem i Ballkanit”.

(Shkëputur nga libri “Amanet Ramazani”)




... koha është shumë e vështirë, përplot frikë dhe pasiguri; sepse i mençuri e ka humbur rrugën, lirinë; sepse njeriu kurrë nuk ka qenë aq i robëruar siç është sot; sepse edhe të mundurën e mbështet diku; sepse ka frikë të mendojë; sepse tradhtia dhe mashtrimi janë bërë “shpëtim”.


Andaj agjërimi është mundësi që të jetë një liri që nuk vjen nga poshtë, por nga lart, dhe që na mundëson të lirohemi nga brengat e sipërpërmendura, ngaqë ajo është mburoja më e mirë.




Ne e kemi të domosdoshme ta ruajmë e ta mbrojmë këtë muaj, sepse ky është muaj që e përgatit shpirtin dhe mendjen e njeriut për shenjat e kiametit; me një fjalë, që e bën njeriun të reshtë së frikësuari.





Koha e agjërimit
është koha kur mbështetet mbi një
lashtësi, e cila me një urtësi të thellë
e mbron dhe e përgatit shpirtin e
njeriut që ta luftojë fuqinë e demonit,
respektivisht shejtanit më të madh në
botë. Ndërkaq shejtani më
i madh në botë sot është teknologjia dhe
“globalizmi”, që na e marrin lirinë dhe
na e robërojnë mendjen dhe nderin.
Agjërimi është kohë dhe mundësi
që në lutje dhe heshtje të luftohet
diçka e tillë.



Kur'ani është fjalë e Zotit që
më tepër e thekson veprimin
sesa idenë .




Paraqitja e Ramazanit,
faktikisht, është një thirrje që
shpirtin e njeriut ta mbajë nën
kontrollin e burimit të vet.





Muaji i agjërimit, përpos ripërsëritjes së besimit, është një mundësi e veçantë që para nesh parashtron disa pyetje, si: si jeni duke i kuptuar fjalët “përgjegjësi”, “gënjeshtër”, “mashttrim”?; si jeni duke i kuptuar fjalët “arsimim”, “edukatë” e “kulturë”?...

Me një fjalë, agjërimi është një moment që na pyet: si jemi duke e zbukuruar jetën, kulturën tonë, duke e mbështetur mbi lirinë që na e ka dhënë Zoti, si në pranimin, ashtu edhe në refuzimin e fesë?




Muaji i Ramazanit kërkon
dhe mundëson që hapësirën
e Kur'anit ta përjetojmë në
gjallërinë e tij. Ai kërkon
nga ne përpjekje, shpirt dhe
vdekje, sikur jemi duke e
lexuar Fjalën e Tij para Tij.




Agjërimi, si lutje, e tejkalon çdo përmasë të lutjeve të tjera, për shkak se për një çast Zoti krejt të lejuarën e bën të ndaluar.

Ai e bën hallallin haram, gjë që për logjikën është e pakapshme.




Këtu vërtetohet edhe ajo se Zoti kur ndalon, nuk ndalon që të krijojë fyerje, por me qëllim që të kërkojë nga krijesa më e lartë vetëm devotshmëri, respekt, heshtje, dëgjim, bindje e flijim.





Agjërimi i muajit të Ramazanit është ndër ndodhitë më gjallëruese që ka mundësi t'i përjetojë besimtari musliman. Në këtë muaj filloi zbritja e vetë Shpalljes, si vulosje e fundit të saj, lufta e Bedrit me ushtarë të dukshëm dhe të padukshëm, një fitore e garantuar nga vetë Zoti. Më në fund, e kemi Tejletu-l Kadrin, që është më e mirë se njëmijë muaj.



Natyrisht, edhe ky muaj i agjërimit
duhet ta përkujtojë besimtarin
për një moment shumë të
rëndësishëm - nijetin. Ai duhet të
betohet se do t'i vazhdojë qëllimet e
veta derisa t'i kryejë në mënyrën më
të mirë, pra se do të bëhet i pjekur,
i rritur dhe do të dijë të vendosë
për iman, fe e vatan.




Në traditën muslimanëve vërejmë një bukuri të jashtëzakonshme dhe kulturë të lartë të gatimit. Për iftar përgatiten ushqime të veçanta ose tradicionale dhe të llojllojshme. Me rëndësi është se te familjet të cilat mundohen të kenë rregulla jetësore dhe kulturë të lartë familjare ose shtëpiake, nga fëmijët dhe të rriturit kërkohet që para iftarit të lexojnë Kur'an, të ulen së bashku në sofrën e iftarit dhe në çastin e iftarit të bëjnë lutje të përbashkët drejtuar Allahut, duke kërkuar nga Ai falje, begati dhe udhëzim jo vetëm për vete, por edhe për mbarë njerëzimin, e sidomos ndihmë për ata të cilëve u bëhet padrejtësi e madhe në këtë botë.





Nuk është e ndaluar të plotësohet dhe të zbukurohet ky moment i rëndësishëm (kohë e iftarit), për çdokënd në mënyrë të veçantë. Ky është prej momenteve kur edhe fizikisht shpirtit i mundësohet të depërtojë, respektivisht ta përjetojë, peshën e metafizikës, duke heshtur, duke u lutur.

Duhet pasur kujdes se si kalohet kjo kohë, ngase ajo nuk e lejon zhurmën e çmendurinë e televizorit dhe mungesën e kulturës.




Muaji i Ramazanit pandërprerë
interpretohet dhe përsëri ka në
vete resurse të pashtershme si
të kuptimit e të përjetimit, ashtu
edhe të interpretimit.


Ajo që e bën të mundur një gjë të
tillë është edhe Nata e Kadrit.




Ngjarja më e rëndësishme e cila ka ndodhur që nga zanafilla e gjinisë njerëzore e deri më sot është bashkimi i botes më të lartë me atë më të ulëtën, bashkimi i Qiellit dhe Tokës, respektivisht shpallja i Kur'anit dhe zbritja e udhëzimit për mbarë njerëzimin, për të udhëzuar në rrugën e drejtë. Pikërisht kjo ka ndodhur në Natën e Kadrit, e cila është natë e zgjedhur dhe prandaj netët e tjera të shënuara, megjithëse secila me rëndësi të veçantë, as që mund të krahasohen dhe ta kenë vlerën që e ka kjo natë.





Agjërimi, nëse kuptohet vetëm si abstenim nga ngrënia e pija, është mjerim, sepse atë e bën vetëm kafsha. Njeriut në këtë kohë i mundësohet që drejtpërsëdrejti të komunikojë me Zotin, që drejtpërsëdrejti t'i lexojë fjalët, respektivisht shenjat e Zotit. Atij i mundësohet të ketë një iftar me mbi një miliard njerëz në kohë të caktuar, i mundësohet që në atë kohë t'i lutet Zotit për çdo send të analizuar e të vendosur mirë e mirë e Zoti t'ia pranojë ato.



*Me agjërimin, si solidaritet
botëror në formë të urisë,
njëkohësisht i shpallet luftë
edhe djallëzisë botërore.*




Është fakt se agjërimin e prishin disa momente nga bota materiale, por - përpos kësaj - feja rëndësi të veçantë i kushton edhe pastrimit të shpirtit, devotshmërisë ndaj Zotit, sepse pa këtë agjërimi e humb formën e shpërblimit dhe merr e formën e dënimit.




Me të vërtetë rregullat fetare
e ftojnë zemrën dhe arsyen
njerëzore, duke mos e komplikuar
dhe vështirësuar normën fetare.




Ato bëjnë thirrje që muslimani
të dijë të besojë, të jetë i mençur,
i lirë e të vendosë të agjërojë, të
bëjë punë të mbara, duke mos iu
frikësuar harresës e lodhjes.




Pranimi i agjërimit duhet të mbështetet mbi burimin e tij, të jetë larg “modernizimit” të tij, respektivisht praktikimit të tij në format që në dukje janë të mira, por që në esencë e burgosin shpirtin dhe ia zënë frymën kulturës.





Kohëve të fundit kanë filluar të organizohen iftare të përbashkëta nga shoqata e individë, me para të grumbulluara nga muslimanët dhe kjo, për fat të keq, është duke u bërë traditë “e domosdoshme”, duke harruar se iftalet e këtilla janë duke ia zënë frymën vahjit, sunnetit të Pejgamberit a.s. dhe lotit të zemrës.




Koha e iftarit është kohë kur
agjëruesi ballafaqohet me
aromën e xhenetit. Iftaret
janë ato që i bashkojnë familjet
dhe që mundësojnë përqaftimin
prind-fëmijë, siç qëndron në një
përshkrim kur'anor.




Muaji i agjërimit është muaji kur ka zbritur/zbret Kur'ani, që neve na mundëson ta mësojmë, ta lexojmë e ta dëgjojmë atë dhe të heshtim, e jo të merremi me vazet që i kapërcejnë përmasat e besimit dhe kulturës, sepse ligjëratat, për momentin, qysh para se të fillojnë janë të vdekura ose shprehin një tautologji të bezdisshme. Ato janë duke na ngarkuar me “përgjegjësi” e “dënim”.




Kultura e të folurit dhe shprehjeve është duke e varfëruar Fjalën e Shpalljes. Vazet kanë arritur në atë derexhe, sa që çdokush që flet “bukur” konsiderohet teolog, pa marrë parasysh thellësinë e urtësisë së teologjisë që e ligjëron. Dëshmi për këtë është se ne jemi të robëruar nga një injorancë “e shenjtëruar”.




Aqjërimi na flet shtruar:
je besimtar - mos u bëj
arrogant; je mosbesimtar - mos
u bëj edepsëz!




Përsëritja e Ramazanit e,
me këtë, edhe përsëritja në
brendësinë e tij edhe e Bedrit, na
fton që çdoherë ta kujtojmë shpëtimin
e njeriut besimtar, duke ia dhënë
sigurinë dhe paqen botës me tërë
bukuritë e saj, vetëm që i ligu, ateisti
dhe antiteisti vulgar të mos marrin
hiov e, më në fund, mbi tokë të
mbisundojnë fuqitë djallëzore.




Nuk është e kotë se për çdo vjet Ramazani paraqitet së bashku me Bedrin: njëri për ta pastruar shpirtërisht mbarë njerëzimin e tjetri për t'u thënë të këqijve se “nuk keni të drejtë të sundoni mbi njerëzinë”.



Itikafi në këtë kohë është ndër virtytet më të larta të njeriut, me ç'rast ai drejtpërsëdrejti e detyron vetveten që të bëhet ndihmëtar i së mirës - fesë dhe u ndihmon engjëjve/melekëve për ta mbyllur shejtanin. Ai bëhet forcë që edhe shejtanin e mallkuar e vë nën sundimin e vet, pastaj bëhet fuqi që i hapë horizontet nga qielli që ta shohë atë që s'ka mundësi ta shohë çdokush, si dhe t'i nënshtrohet Allahut xhel-shanuhu, duke i bërë lutje për shpëtimin e njeriut/njerëzimit, familjes, fëmijëve.




Teksti i shenjtë, në të vërtetë,
është si hekuri i shkrirë që
farkëtohet rishtas, që të mund
të shihet forca e pjesëve të
veçanta të tij.




... ngase fjalët e Shkrimit për
ne janë si udhërrëfyes dhe
shtigje që çojnë në thellësinë e
kuptimit të jetës sonë.


Aty, në të vërtetë, zbulohet
veprimi i tërësishëm shpëtimtar
i Zotit, vullneti i Tij i shenjtë
në të kaluarën, në të tashmen
dhe në të ardhmen.





Në të vërtetë, Zoti dëshiron që
te çdo njeri të arrijë
fjala e Tij dhe të mbillet pors
fara në zemrën e tij dhe aty të
mugullojë dhe të mbijë me fryt.
Pra, fjala e jashtme
e Zotit synon të bëhet fjalë
e brendshme e jona.



Amaneti është term që është
përdorur para kohës dhe
hapësirës dhe është pranuar
vetëm nga njeriu.





Vërtet, është e gjallë dhe
efikase Fjala e Zotit.
Ajo është më e mprehtë se çdo
shpatë me dy tehe. Dhe, ajo
depërton deri aty sa e ndan
shpirtin dhe frymën...




Teologjia e emancipimit aPOSE çlirimit në këtë muaj kërkon nga ne shqyrtimin dhe ruajtjen e amanetit të dhënë në Eden. Nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë në e kemi tradhtuar premtimin që ia kemi dhënë Zotit. Emancipimi shpirtëror, kulturor e shkencor mund të bëhet kurdoherë.

Roli i teologjisë është shumë i madh. Ajo garanton suksese vetëm atëherë kur me vetëdije, dashuri e dëshirë i nënshtrohemi Zotit. Përndryshe, nuk do t'i largohemi hijes së robërimit.






Prapë po vjen muaji i agjërimit
- Ramazani. Pse?


Sipas asaj që veprohet,
respektivisht, sipas asaj që është
bërë shprehi ndër ne, ne nuk
kemi Ramazan të ri, por të
përsëritur, kurse Ramazani i
Lotit është gjithnjë i ri.




Ky duhet të jetë muaji i një fillimi të ri dhe atë që nga plotësimi i besimit e deri te ringjallja e fesë, sepse këtë tablo ekzistuese nuk kemi mundësi ta largojmë ndryshe ne, nga njeriu, derisa ai të mos frymëzohet ashtu siç e urdhëron Shpallja.




Muaji i heshtjes, agjërimi, është ky.
Ky muaj që kërkon nga ne të heshtim nga
të folurit e kotë, por të mos heshtim përballë
të pavërtetës. Ai kërkon që zemra jonë të
jetë e plotësuar dhe e ndriçuar me Shpalljen
e Kur'anit. Ai pret të shtohet devotshmëria,
të shumëzohet vëllazërimi njerëzor, të
kuptohen besimtari dhe jobesimtari, të
respektohet feja e tjetrit.
Në këtë muaj kërkohet nga ne të mbisundojë
kultura e lartë në xhami, sexhdeja
të jetë e plotësuar.
Gjatë Ramazanit kërkohet nga ne të jemi
larg nga format e ndryshme që për çdo
ditë kanë filluar të bëhen forma që krijojnë
urrejtje dhe mashtrim
Në këtë muaj kërkohet të mendohet vetvetja
dhe në këtë vetvete të futet edhe tjetri.



Krijuesi e zbukuron njeriun, duke ia dhuruar këtë muaj të një metafizike, të cilën e ka përjetuar shpirti edenian dhe e ka zbukuruar dhe edukuar në këtë formë. Kjo formë e agjërimit ia mundëson njeriut ta shohë fillimin dhe fundin e vet, ta përjetojë fuqinë e Zotit me përsëritjen e Shpalljes, që vetëm e lartëson këtë krijesë që ka flijuar shumë me pranimin e amanetit të Zotit.



Në të vërtetë, në Natën e Kadrit ndodh pranvera metafizike e Fjalës së Zotit, ndërsa gjatë agjërimit piqet vjeshta eskatologjike me të gjitha frytet e veta shpirtërore, nga të cilat më të çmuara janë fryti i mëshirës (rahmet), fryti i faljes (magfiret) dhe fryti i shpëtimit (selamet).



Nata e njëzeteshtatë e Ramazanit (Lejlet-ul Kadr) është koha nyjore vertikale e Ramazanit, ndërsa dhurata shpirtërore e agjërimit (Saum) është kohë nyjore e horizontales së Ramazanit.